Bashkia e Tiranës

Drejtoria e Strehimit Social

Programet aktuale të strehimit

- Programi i Subvencionimit të Interesave të Kredisë
  - (është shuma në të holla që përfiton individi/familja nga institucionet shtetërore, me qëllim mbulimin e interesave të kredisë, të marrë me kushte lehtësuese për blerjen e banesave me kosto të ulët.) – Ligji 22/2018; Neni 2; Pika 43
- Programi i Banesave Sociale me Qira
  - (është banesa që jepet me qira, në pronësi publike, nga fondi publik i banesave sociale.) – Ligji 22/2018; Neni 2; Pika 6
- Programi i Subvencionimit të Qirasë
  - (është shuma e të hollave që jepet nga institucionet shtetërore për llogari të përfituesit, me qëllim mbulimin e pjesës së qirasë, e cila nuk përballohet me të ardhurat e përfituesit.) – Ligji 22/2018; Neni 2; Pika 42

Disa statistika

- Programi i Subvencionimit të Interesave të Kredisë
  - Në dy vitet e fundit janë shpallur **2.103 familje** përfitues.
- Programi i Banesave Sociale me Qira
  - Aktualisht janë **385 familjet** e strehuara në këtë program
- Programi i Subvencionimit te Qirasë
  - Aktualisht janë **255 familjet** që përfitojnë nga ky program

Burimet e Financimit

1. Programet e Subvencionimit të interesave të Kredisë dhe të Qirasë janë mbështetur 100% nga fondet e Bashkisë Tiranë.

2. Marrëveshje me CEB për programin e Banesave Sociale me Qira.

3. Fonde të siguruara nga donatorët ndërkombëtarë.

Procesi i Aplikimit

- Faza I
  - Vetëdeklarimi pranë Njësisë Administrative
  - Aplikimi përmes plotësimit të Formularit të Strehimit (FS)
- Faza II
  - Dorëzimi i dokumentacionit sipas kërkesave të vkm 574, datë 29.08.2012
  - Shqyrtimi pranë Komisionit të Strehimit
- Shpallja publike e përfituesve

Të dhënat që mund të gjenerohen nga aplikimi

1. Të ardhurat familjare
2. Punësimi
3. Informacion mbi pronën
4. Gjëndja aktuale e strehimit
5. Situata shëndetësore dhe sociale e familjes
6. Arsyet të tjera që kanë nxitur kërkesën për strehim

TREGUESIT KRYESORË TË PËRDORUR AKTUALISHT PËR TË HARTUAR, RISHIKUAR DHE ZBATUAR POLITIKAT E STREHIMIN

1. Demografik
   - Në Tiranë jetojnë më shumë se 30% e popullësisë së vendit dhe cdo vit qyteti rritet me 25.000 banor të rinjë (v. 2019). Shumica e tyre si pasojë e lëvizjeve migratore. Ndërkohë më shumë se 5.000 janë çiftet e reja të sapomartuara në kryeqytet (v. 2014).

2. Ekonomik
   - 2.599 Familje përfituese të ndihmës ekonomike

3. Social
   - 23.807 Persona me aftësi ndryshe
   - 850 Familje Rome dhe Egjiptiane
   - 227 Jetim
   - 61 Viktima të dhunës në familje

TREGUESIT KRYESORË TË PËRDORUR AKTUALISHT PËR TË HARTUAR, RISHIKUAR DHE ZBATUAR POLITIKAT E STREHIMIN

- Papunësia
  - 10.031 Persona të regjistruar si të papunë.

- Përfitues të shërbimeve sociale
  - 1.159 përfitues nga të cilët 212 janë të moshuar dhe 105 gra të dhunuara të cilët përbëjnë edhe kategorinë më të prirur për nevojën e strehimit.

PROBLEMATIKAT

1. Mungesa e akteve nënligjore në përputhje me ligjin 22/2018
2. Hartimi i programit 5-vjeçarë për strehimin i cili mund të miratohet vetëm pasi të jenë përfunduar aktet nënligjore të ligjit 22/2018
3. Problemet me pronën dhe mungesa e truallit publik për të ndërtuar banesa sociale.
4. Mungesa e informacionit statistikor nga tregu imobiliar dhe institucionet përkatëse)
5. Mungesa e minimumit jetik.

PRITSHMERITE

- Plotësimi i ligjit 22/2018 me aktet nënligjore.
- Hapjen e programeve të reja të strehimit sic janë parashikuar në ligjin 22/2018, brënda vitit 2021.
- Krijimi i hapsirave të reja infrastrukturore dhe urbane për ndërtimin e banesave sociale.
- Përmirësimi i programeve aktuale të strehimit social.